



VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 03/2015

NDRYSHIMET NË PAJISJET ELEKTRONIKE FISKALE- APLIKIMI I NORMËS SË REDUKTUAR TË TVSH-SË

Qëllimi

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është sqarimi :

- për tatimpaguesit e pajisur me Pajisje Elektronike Fiskale (PEF) për nevojën e adaptimit të pajisjeve me kërkesat ligjore që rezultojnë nga aprovimi i Ligjit Nr. 05/L-37 për TVSH respektivisht fillimit të zbatimit të tij nga data 01.09.2015;
- për Operatorët Ekonomik të licencuar dhe ata potencial që tregtojnë, instalojnë dhe mirëmbajnë Pajisje Elektronike Fiskale se, të gjitha PEF-et aktive dhe ato që do të instalohen në të ardhmen, duhet tu përshtaten specifikave funksionale dhe teknike të publikuara në web sipas dokumentit “PAJISJET ELEKTRONIKE FISKALE, KËRKESAT, KARAKTERISTIKAT FUNKSIONALE DHE TEKNIKE“.

Ndryshimet në PEF

Ndryshimet në PEF nënkuptojnë adaptimin e tyre me kërkesat e reja ligjore që derivojnë nga Ligji Nr. 05/L-37 për TVSH ku, për dallim prej ligjit aktual (Ligji Nr. 03/L-146 për TVSh) sipas të cilit TVSH ngarkohet me normën prej 16%, Ligji Nr. 05/L-37 parasheh, përpos normës standarde prej 18% parasheh edhe normën e reduktuar prej 8% e cila do të llogaritet dhe paguhet për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve si dhe importit të tyre, si në vijim:

- ✓ furnizimi me ujë, përveç ujit të ambalazhuar;
- ✓ furnizimi me energji elektrike përfshirë edhe shërbimet e distribuimit dhe transmissioinit, me ngrohje qendrore, mbledhjen e hedhurinave dhe trajtimin e mbeturinave tjera;
- ✓ drithërat sikurse janë elbi, misri, varietetet e misrit, tërshëra, thekra, orizi dhe gruri;
- ✓ prodhimet e bëra prej drithërave për qëllim të konsumimit njerëzor, sikurse janë mielli, brumërat, buka dhe prodhime të ngjashme;
- ✓ vajrat për gatim të bërë nga drithërat apo farërat vajore për përdorim në gatim për konsumim njerëzor;
- ✓ qumështi dhe produktet e qumështit me qëllim për konsumim njerëzor;
- ✓ kripa e përshtatshme për konsum njerëzor;



- ✓ vezët për konsum;
- ✓ librat shkollore dhe publikimet serike;
- ✓ furnizimi duke përfshirë huadhënien e librave nga bibliotekat (duke përfshirë broshurat, fletëpalosjet dhe materialet e ngjashme të shtypura, librat me fotografi për fëmijë, librat për vizatim dhe ngjyrosje, librat e muzikës në formë të shtypur apo të dorëshkrimit, hartat dhe grafiqet hidrografike dhe të ngjashme);
- ✓ pajisjet e teknologjisë së informacionit;
- ✓ furnizimi i barnave, produkteve farmaceutike, instrumenteve dhe aparateve mjekësore dhe kirurgjike;
- ✓ pajisjet mjekësore, autoambulancat, ndihmat dhe aparatet tjera mjekësore me qëllim që të lehtësojnë ose trajtojnë paaftësinë për shfrytëzim ekskluziv të të paaftëve, duke përfshirë riparimin e këtyre mallrave dhe furnizimin e ulëseve të fëmijëve për vetura.

Të gjithë tatimpaguesit të cilët janë deklarues të TVSh-së dhe janë të pajisur me PEF, deri më datën 31 Gusht 2015 duhet të bëjnë rregullimet e nevojshme në programet dhe Pajisjet e tyre Elektronike Fiskale, duke vendosur normat e reja të TVSh-së prej 8% dhe 18% dhe nga data 01 Shtator 2015 duhet të fillojnë të aplikojnë këto norma, varësisht nga furnizimi i mallit apo shërbimit.

Për të rregulluar normat e reja të TVSh-së, duhet kontaktuar operatorin gjegjës ekonomik, (prej të cilit është blerë pajisja) i cili do të kryejë procesin e vënies së këtyre normave në Pajisjen tuaj Elektronike Fiskale.

Aplikimi i normës së vjetër të TVSh-së prej 16%, do të bëhet vetëm deri më 31 Gusht 2015.

Obligimet për Operatorët e Licencuar për PEF

Operatorët e Licencuar për PEF duhet tu përmbahen specifikave funksionale dhe teknike që janë të publikuara në dokumentin “PAJISJET ELEKTRONIKE FISKALE, KËRKESAT, KARAKTERISTIKAT FUNKSIONALE DHE TEKNIKE” gjegjësisht Nenit 7, paragrafit 3.3 të tij.

Ndryshimi i normave tatimore sipas pakos së re fiskale bëhet vetëm nga Tekniku i Autorizuar i Operatorit Ekonomik të Licencuar dhe renditja në PEF, në përputhje me dokumentin e sipërpërmendur, duhet të bëhet si në vijim:

A	nënkuptohet shkalla tatimore e përjashtuar
B	shkalla tatimore prej 16%
C	Për tatimpaguesit që nuk kanë detyrim pagese të TVSH-së shkalla tatimore për TVSH në kupon do të përdoret ajo me zero 0 (shkronja C), por jo e përjashtuar
D	shkalla tatimore prej 8%
E	shkalla tatimore prej 18%



AT

Pas datës 31 Gusht 2015, norma tatimore prej 16% (B) duhet të bëhet jo-aktive dhe të jetë e lirë nga Operatorët Ekonomik.

Data: 03 / 08 / 2015

U.d Drejtori i Përgjithshëm, ATK

per,


(Nahit Sharku)

